



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE JANAR – DHJETOR 2011

I. HYRJE

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2011, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka realizuar 17 raunde vëzhgimesh në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në: “Mine Peza” Tiranë, “Jordan Misja” në Tiranë, “Ali Demi” në Tiranë, “Shën Koll” Lezhë (3 raunde), “Peçin”, “Bënçe” të Tepelenës, “Burrel”, “Fushë–Krujë” (3 raunde), “Berat (Paraburgim)”, “Rrogzhinë”, “Korçë”, “Sarandë (Paraburgim)” dhe “Vlorë (Paraburgim)”.

Vëzhgimet e kryera kanë patur në fokus kushtet e jetesës së personave të paraburgosur dhe të dënuar; respektimin e të drejtave të tyre nga stafi i institucionit, përfshirë dhe aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë penale si, prokuroria, gjykata dhe policia; verifikimin e ankesave të ardhura në adresë të KShH-së nëpërmjet telefonit, letrave ose nga takimet e zhvilluara në zyrë me familjarët e të dënuarve/paraburgosurve; ofrimin e shërbimeve ligjore falas, etj.

Vëzhgimet e kryera kanë qenë periodike dhe sporadike. Vëzhgimet sporadike janë kryer për të verifikuar ankesat që personat e privuar nga liria i kanë drejtuar KShH-së, në kuadër të programit “Klinika Ligjore Falas” dhe në kuadër të sinjalizimeve të medias së shkruar dhe asaj elektronike. Gjatë vitit 2011, KShH ka marrë ankesa kolektive nga të dënuar në tre institucione, respektivisht Shën Koll, Fushë – Krujë dhe Korçë. Objekti i ankesave të ardhura ka konsistuar, kryesisht, në kushtet e këqija të jetesës në institucion dhe në trajtimin jo human nga stafi i institucionit.

Standardet mbi të cilat jemi bazuar për realizimin e këtyre vëzhgimeve, kanë qenë ato të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar, veçanërisht në Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve” (i ndryshuar), dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve (e ndryshuar).

Kohët e fundit janë bërë përmirësime në sistemin e burgjeve, kryesisht si rezultat i investimeve për përmirësimin e infrastrukturës, ndërtimin e paraburgimeve dhe burgjeve të reja si dhe ritjeten e kapaciteteve të stafit të këtyre institucioneve.

II. PROBLEMATIKA E KONSTATUAR

2.1 Infrastruktura dhe Kushtet Fizike

Gjatë vitit 2011, KShH ka vërejtur, pothuaj, të njëjtat probleme që lidhen me infrastrukturën e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të konstatuar edhe nga vëzhgimet e kryera vitet e mëparshme. Ka ende institucione të vendosura në godina të vjetra, si I.E.V.P



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

“Tepelenë”, “Burrel”, “Rrogozhinë”, “Berat” dhe “Sarandë”. Problemet kryesore të këtyre godinave janë lagështira, amortizimin i tepërt, si dhe mungesa e ndriçimit natyror.

Në paraburgimin e Beratit, u konstatuan disa përmirësime në infrastrukturën e vendit të ajrimit, duke krijuar kështu një hapësirë më të madhe për ajrimin e të paraburgosurve. Infrastruktura e vendeve të takimit me familjarët ishte e papërshtatshme dhe cënonte privatësinë e bisedës midis tyre¹. Paraburgimi i Sarandës nuk dispononte një fond të veçantë që të mundësonte përmirësimin e kushteve infrastrukturore, të cilat nuk plotësonin standartet e parashikuara për respektimin e të drejtave të personave të paraburgosur.

Gjatë verifikimeve të ankesave të ndryshme, ndër to dhe në IEVP e “Shën Kollit”², u vërejt se ambientet e institucionit ku ishin vendosur të dënuarit, nuk ofronin kushtet e nevojshme për një trajtim human. Në disa nga dhomat e vëzhguara kishte mungesa të pajisjeve të nevojshme për fjetje, si jastëkë, çarçafë, dyshekë dhe mungesë të mjeteve për sigurimin e higjienës në dhoma, të cilat siguroheshin kryesisht nga familjarët e të dënuarve. Dritaret ishin të amortizuara dhe nuk mundësonin izolimin nga temperaturat e ulëta dhe kushtet e këqija atmosferike, veçanërisht në kohë të ftohtë e me shi. Amortizimi, lagështira si dhe mungesa e ngrohjes shkatonte mjaft probleme, veçanërisht në kushtet e temperaturave të ulta atmosferike. Probleme të infrastrukturës u vërejtën në dushet dhe tualetet e përbashkëta. Në disa nga tualetet mungonin dyert, çka mund të shkaktonte shkelje të së drejtës së privatësisë për të burgosurit. Gjithashtu, kishte probleme të furnizimit me ujë të rrjedhshëm, për shkak të amortizimit dhe daljes jashtë funksionit të sistemit të çezmave.

KShH vërejt probleme infrastrukturore edhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të ndërtuara vitet e fundit si në Fushë Krujë dhe Korçë. Në muajin tetor, nga vëzhgimi i kryer në vijim të një ankese kolektive të ardhur nga të dënuarit e I.E.V.P - së Fushë – Krujë, u konstatua mungesa e dusheve, kufizime të ujit të rrjedhshëm dhe mosfurnizimi me *ujë të ngrohtë*. Në regjimin e sigurisë së zakonshme, në këtë institucion, u konstatua se dushet dhe një pjesë e çezmave ishin jashtë funksionit. Edhe në I.E.V.P Korçë, gjatë vëzhgimit të realizuar në muajin korrik, u konstatua se në përgjithësi infrastruktura dhe kushtet e jetesës nuk ishin në përputhje me kërkesat ligjore. Në këtë institucion u vërejtën mangësi në pajisjen me mjetet e nevojshme për fjetje si, çarçafë, mbulesa dhe mjetet e nevojshme për mbajtjen e higjienës personale. Për shkak të orareve të kufizuara të ujit, në disa raste, përdorimi i dusheve kryhej në intervale një herë në 10 ditë.

2.2 Mbipopullimi

Mbipopullim i lartë u vërejt, veçanërisht, gjatë vëzhgimeve të kryera në I.E.V.P “Fushë – Krujë”, “Vlorë” dhe “Rrogozhinë”. Në I.E.V.P Fushë – Krujë, kapaciteti i dhomave të vëzhguara ishte 4 persona për dhomë, ndërkohë që për shkak të mbipopullimit, në këto dhoma mbaheshin 6 deri në 7 persona. Problemi i mbipopullimit kishte shkakuar probleme të komunikimit midis të dënuarve dhe institucionit. Ky i fundit kishte kufizuar numrin e televizorëve në dhoma, ndërkohë që sipas të dënuarve, ky kufizim kishte cënuar plotësimin e nevojave të personave që qëndronin në ato dhoma.

¹ Familjarët qëndronin në ambientet e jashtme të godinës dhe të paraburgosurit qëndronin në dhomat e takimeve. Biseda midis tyre realizohej nëpërmjet një xhami ndarës, duke i privuar ata nga çdo lloj kontakti fizik dhe duke cënuar privatësinë e bisedës.

² Ankesë kolektive ku disa të dënuar ishin futur në greve urie



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në I.E.V.P Rrogozhinë dhe Berat, gjatë vëzhgimit, u konstatuan dy raste të personave që flinin me dyshekë të vendosur në tokë, për shkak se ishte tejkaluar kapaciteti i parashikuar për vendosjen e personave në ato dhoma. Kjo krijonte trajtim të diferencuar të të burgosurve në të njëjtën dhomë.

Në seksionin e të miturve në Paraburgimin e Vlorës, në një prej dhomave të vizituara gjatë monitorimit, u konstatua se ishin vendosur 7 të mitur të paraburgosur, për shkak të mbipopullimit në institucion. KShH konsideron se qëndrimi i një numri të lartë të miturish në të njëjtën dhomë, nuk është i përshtatshëm si dhe duhet ti kushtohet më shumë vëmendje nga ana e stafit të Institucionit për shkak të moshës së tyre si grup vulnerabël.

2.3 Organika

Në pjesën më të madhe të institucioneve të vëzhguara kishte mungesë personeli, kryesisht në sektorin e shërbimit shëndetësor. Mungesa të tilla u vërejtën në I.E.V.P-të “Burrel”³, “Berat”⁴, “Lezhë”⁵ dhe “Sarandë”⁶. Mungesa e personelit mjekësor, kryesisht mjek me kohë të plotë, justifikohet nga drejtuesit e institucionit si rezultat i pagesës të vogël, e cila nuk i motivonte personat për të aplikuar në vendet vakante.

KShH sugjeron që të shikohet me përparësi problemi i mungesave në sektorin shëndetësor, i cili është një ndër sektorët e rëndësishëm të institucionit, që garanton kujdesin për shëndetin e personave të privuar nga liria. KShH sugjeron për zgjidhjen e këtij problemi, rritjen e nivelit të pagës së mjekëve që do të ofrojnë shërbime në këto institucione, veçanërisht në ato me kapacitet të lartë, angazhimin e mjekëve stazhierë në institucione me kapacitete të ulëta si “Berati” dhe “Saranda”, apo zgjidhje të tjera alternative.

2.4 Ajrimi

Gjatë vitit 2011, në programin e Klinikës Ligjore, ka patur disa raste sporadike të referuara me anë të telefonit, ku të dënuarit kanë pretenduar se janë diskriminuar për sa i takon kohëzgjatjes së qëndrimit në ajrim, në raport me të dënuarit e tjerë⁷. Në pjesën më të madhe të I.E.V.P-ve të vëzhguara si: në “Lezhë”, “Tepelenë”, “Rrogozhinë”, “Burrel”, kushtet infrastrukturore nuk mundësonin ajrim të përshtatshëm të personave të privuar nga liria, veçanërisht në kushte atmosferike me mot shumë të nxehtë ose me reshje shiu/bore. Arsyeja ishte se ambientet e ajrimit nuk ishin të mbuluara me tendë.

Në I.E.V.P Lezhë u vu re se në ambientet e observimit personat e sapopranuar në institucion mbaheshin tej afatit 10 ditor të parashikuar në ligj. Për shkak të observimit, këta persona privoheshin nga pjesëmarrja në aktivitetet e përbashkëta, përfshi edhe të drejtën për të dalë në ajrim.

³ Mungesa e një mjeku me kohë të plotë

⁴ Mungesë e një mjeku me kohë të plotë dhe një farmacisti

⁵ Mungesa e personelit mjekësor për trajtimin e 25 të sëmurëve mendorë që ndodheshin në insitucion gjatë vëzhgimit

⁶ Mungesa e një mjeku me kohë të plotë.

⁷ Sipas ankesave të ardhura pretendohet se edhe pse ndaj këtyre personave është respektuar minimumi i kohëzgjatjes së parashikuar në ligj për ajrimin (2 orë), të dënuarve të tjerë u janë krijuar privilegje, duke i lejuar atyre ajrosjen tej këtij kësaj kohëzgjatjeje.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2.5 Shërbimi Shëndetësor

Për sa i takon ndihmës mjekësore në burgje, GJEDNJ⁸ në jurisprudencën e saj pranon se *ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut jo gjithmonë mund të jetë në të njëjtin nivel si ndihma e ofruar në spitalet më të mira mjekësore për publikun e gjerë. Gjithsesi, Shteti duhet të garantojë shëndetin dhe mirëqenien e të burgosurve nëpërmjet, inter alia, ofrimit të ndihmës së nevojshme mjekësore. Në çështjen Grori k.Shqipërisë GJEDNJ konstatoi se, “mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e dubur, që iu shtua refuzimit të autoriteteve për t’i ofruar z.Grori trajtimin e dubur mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e Nenit 3”.*

Ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur” dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve parashikojnë kontrolle mjekësore periodike, të të gjithë personave të dënuar dhe të paraburgosur, nga stafi i sektorit të shërbimit mjekësor. KShH në disa raste vërejt se këto dispozita nuk respektoheshin.

Në I.E.V.P Burrel, nga vëzhgimi i kartelave mjekësore të të dënuarve, rezultoi se frekuenca e kontrolleve mjekësore ishte shumë e rrallë⁹. Shpesh pretendimet e të dënuarve për nevojë të kontrollit mjekësor nuk pranoheshin nga stafi mjekësor.

KShH vlerëson si shumë të rëndësishëm hedhjen e të dhënave, që rezultojnë nga vizita mjekësore, në kartelat individuale të të dënuarve dhe paraburgosurve, gjatë ose menjëherë mbas kontrollit mjekësor, si dhe nënshkrimin nga ana e personit të ekzaminuar në kartelën përkatëse. Kjo është e vetmja mënyrë për të provuar ofrimin e shërbimit mjekësor në mënyrë periodike ndaj personave të dënuar dhe të paraburgosur.

Në I.E.V.P Fushë – Krujë¹⁰ dhe Burrel u konstatuan të sëmurë kronikë me diagnoza të rënda, të cilët për arsye të specifikës së sëmundjes, klimës së vendit ku ndodhej institucioni dhe mungesës së stafit të specializuar për këto lloj sëmundje, duheshin transferuar në Qendrën Spitalore të Burgjeve (Q.S.B), ose në I.E.V.P të tjera të cilat kanë klimë dhe staf mjekësor më të përshtatshëm për ndjekjen e sëmundjeve të tyre. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj¹¹ ka vlerësuar se, “janë tre elementë të veçantë që duhen marrë në konsideratë për sa i takon përshtatshmërisë së shëndetit të një personi të privuar nga liria në raport me qëndrimin e tij në institucionin e mbyllur: (a) kushtet mjekësore të të burgosurit, (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burg; dhe (c) kësbillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të ankesit”.

KShH sugjeron që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bashkëpunim me specialistë nga Ministria e Shëndetësisë, të kryejë një inspektim në institucionet ku janë vendosur persona me sëmundje të rënda, në mënyrë që të vlerësohet më mirë mundësia e ofrimit të shërbimit të nevojshëm mjekësor, ndaj të dënuarve/paraburgosurve, në kushtet e këtyre institucioneve.

⁸ Shih Kudla k. Polonisë, Hurtado k. Zvicrës, Kalshnikov k. Rusisë, Grori k.Shqipërisë, etj.

⁹ Në ato kartela që u vëzhguan, kjo frekuenca mesatare ishte 4-5 muaj.

¹⁰ Në I.E.V.P-në Fushë Krujë është akomoduar një i dënuar që vuan nga sëmundja e epilepsisë, diabetit dhe tensionit të lartë neurogjien, i cili në momente të caktuara bëhet shumë i dhunshëm duke shkaktuar vetëlëndime dhe shqetësim për shokët e dhomës dhe ambientin përreth. Në I.E.V.P Burrel, i cili nuk ka mjek full – time, gjatë vëzhgimit kishte 37 të sëmurë kronikë, nga të cilët pjesa më e madhe vuajnë nga neuroza dhe 2 janë diabetikë.

¹¹ Melnik K. Ukrainës, nr. 72286/01, § 94, 28 Mars 2006; Rivière k. Francës, nr. 33834/03, § 63, 11 Korrik 2006



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Për sa i takon furnizimit me ilaçe, u vërejtën mungesa në Institutin e Burrelit dhe të Beratit. Kryesisht këto mungesa u konstatuan për medikamente të shtrenjta, që përdorin të sëmurët kronikë, por edhe për antibiotikë. Në kushtet e këtyre mungesave ata e siguronin mjekimin vetë, ose nëpërmjet familjes. Në paraburgimin e Beratit, nuk kishte dhomë mjeku dhe ilaçet mbaheshin në vend të papërshtatshëm, për shkak edhe të mungesës së ambienteve për shërbimin farmaceutik.

Në I.E.V.P Korçë, në kohën e vëzhgimit, u konstatuan 9 të sëmurë diabetikë, të cilët furnizoheshin me produkte ushqimore një herë në 10 ditë dhe i gatuanin vetë në dhomat e ndenjes. Për shkak të specifikës së kësaj sëmundje, jemi të mendimit se këta të sëmurë duhet të ushqehen sipas një diete të përcaktuar nga mjeku dhe ushqimet e tyre duhen gatuar në guzhinë, për të shmangur keqpërdorimin dhe abuzimet e mundshme me to.

2.6 Trajtimi Social - Edukativ

Infrastruktura e limituar dhe/ose e papërshtatshme, si dhe mungesa e fondeve për zhvillimin e aktiviteteve sociale – edukative ndikonte negativisht në trajtimin social – edukativ të personave të dënuar dhe të paraburgosur, në disa nga institucionet e vëzhguara. Në I.E.V.P Tepelenë, mungesa e ambienteve dhe e bazës materiale mbështetëse, përbënte pengesë në realizimin e plotë të aktiviteteve me karakter social - edukativ. I.E.V.P Burrel nuk dispononte një fond të veçantë për realizimin e shërbimeve dhe aktiviteteve me karakter social-edukativ.

Në I.E.V.P Lezhë dhe Korçë nuk kishte ambiente të posaçme për ushtrimin e aktiviteteve sportive. Këto aktivitete ushtroheshin në ambientet e ajrimit, të cilat ishin të kufizuara dhe të papërshtatshme. Në I.E.V.P Lezhë ekzistonte një fushë me hapësirë të konsiderueshme, por mungesa e investimeve e kishte bërë të pamundur transformimin e saj në një mjedis për ushtrimin e aktiviteteve sportive. Gjithashtu, biblioteka e seksionit të të miturve në I.E.V.P Lezhë ishte shumë e varfër me libra.

Në I.E.V.P Korçë, mungonin programet sociale dhe edukuese. Në institucion nuk funksiononte asnjë kurs i formimit profesional. Të dënuarit, gjithashtu pretendonin se punonjësit e edukimit nuk kishin një komunikim të afërt dhe sitematik me ta. Po ashtu ekzistenca e një psikologu të vetëm, ndërkohë që në organikë ishin parashikuar dy, nuk mundësonte trajtimin të përshtatshëm psikologjik të të dënuarve.

Në paraburgimin e Vlorës, të miturit merrnin pjesë në disa aktivitete me karakter social-edukativ si aktivitete sportive, kinema, kurse kompjuteri, italishteje, trajtonin tema me karakter edukativ, etj. Por këta të mitur, gjatë kohës së qëndrimit në këtë institucion nuk ndiqnin lëndë dhe programe mësimore të arsimit përkatës. Neni 37 i Ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur” parashikon se: *Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhet me anë të organizimit të shkollës, e detyrueshme për të miturit, si dhe të kurseve profesionale, sipas shteteve në fuqi.* Duke patur në konsideratë se një pjesë e këtyre të miturve qëndronin për një kohë të gjatë në këtë institucion, marrja e dijeve për disa nga lëndët bazë të kurrikulës arsimore, do të ndihmonte në integrimin sa më të shpejtë të tyre në shkollë dhe shoqëri, mbasi ata do liroheshin nga paraburgimi.

2.8 Mekanizmi Kërkesë - Ankesë / Rastet Korruptive



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Mekanizmi kërkesë – ankesë është një garanci e rëndësishme procedurale që ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ofron ndaj personave të privuar nga liria, në rastet kur ata pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur, ose kërkojnë të ushtrojnë një të drejtë ligjore.

Vëzhguesit e KSHH-së kanë marrë ankesa për mosfunksionim të këtij mekanizmi gjatë dy vëzhgimeve të kryera në muajt shtator dhe tetor 2011, në I.E.V.P-në Fushë – Krujë. Gjithashtu, në të dy vëzhgimet e kryera në këtë institucion, të dënuarit ngritën pretendime edhe lidhur me praktikën korruptive të ndjekura për dhënien e lejeve shpërblyese dhe punësimit të të dënuarve.

Ankesa të të dënuarve ka patur edhe në drejtim të çmimeve të artikujve që shiten në dyqanet që funksionojnë në disa I.E.V.P. Ankesa të tilla kishin personat me liri të kufizuar në I.E.V.P Lezhë, Korçë dhe Fushë – Krujë. Të dënuarit pretenduan se çmimet e artikujve ishin më të larta në raport me çmimet e zonës përreth, ku ndodhej I.E.V.P-ja.

2.9 Trajtimi Human

Lidhur me trajtimin human, GjEDNj ka vlerësuar në jurisprudencën¹² e saj se “Shteti duhet të sigurojë që personi të privohet nga liria në kushte të cilat janë të përshtatshme, në respekt të dinjitetit të tij njerëzor, se mënyra dhe metoda për ekzekutimin e masës së sigurisë/dënimin të tij nuk do t’i shkaktojnë atij ankth dhe vuajtje të një intensiteti të tillë që kalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që është pjesë e pandashme e ambientit të mbyllur”. GjEDNj vlerëson gjithashtu se “Megjithëse qëllimi i këtij trajtimi është faktor që duhet marrë në konsideratë, veçanërisht për të vlerësuar nëse synohet poshtërimi ose përulja e personit, mungesa e qëllimit, nuk të çon në mënyrë të pashmangshme në përfundimin se nuk ka shkelje të nenit 3 të Konventës?” (shih Peers k. Greqisë). Ky konstatim i GjEDNj-së është veçanërisht i rëndësishëm në raport me kushtet që institucioni ofron për personat e privuar nga liria, të cilat edhe pse në thelb nuk kanë si synim të çenojnë dinjitetin e tij, janë në shkelje të nenit 3 të Konventës dhe përbëjnë trajtim jo human.

Rastet e pretenduara nga personat e privuar nga liria për mungesë të etikës së komunikimit, ushtrim presioni, ushtrim dhune psikologjike dhe në raste të rralla pretendime për ushtrim dhune fizike, nga stafi i institucionit, kanë lëkundur besueshmërinë e këtyre personave në aspektin human të ekzekutimit të dënimin me burgim.

Në vëzhgimet e kryera në muajin janar 2011, në I.E.V.P Lezhë dhe në muajin tetor në I.E.V.P Fushë – Krujë, në vijim të ankesave kolektive të ardhura nga këto institucione, të dënuarit e kontaktuar pretenduan mungesë të etikës së komunikimit nga stafi i regjimit të brendshëm dhe mos respektim të dinjitetit të tyre gjatë kontrolleve në dhoma. Të dënuarit e I.E.V.P-së Lezhë pretenduan dëmtime të sendeve personale, gjatë realizimit të këtyre kontrolleve, ndërsa të dënuarit e I.E.V.P-së Fushë – Krujë ngritën shqetësimin për kontrolle të shpeshta në dhomë, në disa raste edhe në orare te papërshtatshme të natës¹³. Mungesa e etikës së komunikimit me personat e dënuar, nga stafi i regjimit të brendshëm, u konstatua prej vëzhguesve të KSHH-së në I.E.V.P Fushë – Krujë, gjatë vëzhgimit të kryer në muajin Maj të këtij viti. Gjithashtu gjatë

¹² *Kudla k. Polonisë*

¹³ Arsyeja e kontrolleve të shpeshta ishte rritja e sigurisë në institucion, si rezultat një tentative arratisjeje të ndodhur pak kohë më parë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vëzhgimit të kryer në I.E.V.P Korçë, të dënuarit pretenduan se dhunoheshin psikologjikisht nga stafi i institucionit.

Për sa i takon pretendimeve për ushtrim dhune, krahasimisht me vitet e kaluara, në vitin 2011 ka patur një numër më të ulët të ankesave me këtë objekt. Gjatë vëzhgimeve, monitoruesit e KShH-së kanë marrë kontakt me tre të dënuar, përkatësisht në I.E.V.P Burrel, Fushë - Krujë dhe Korçë, të cilët pretendonin se ishin dhunuar nga stafi i institucionit. Në I.E.V.P Burrel, i dënuari pretendonte se pasi ishte dhunuar fizikisht nga stafi i regjimit të brendshëm të institucionit, ishte mbajtur për 9 ditë në dhomat e veçimit dhe se nevojat për tualet i ka kryer në dysheme, sepse nuk i jepej mundësia të shkonte në tualet. Ai është vizituar nga mjeku i institucionit pas 2 – 3 ditësh nga koha kur pretendonte se ishte dhunuar por, në kartelën e tij mjekësore nuk figuronte asnjë dëmtim trupor. Në I.E.V.P në Fushë – Krujë, i dënuari pretendoi se ishte dhunuar nga punonjësit e rolit bazë të institucionit dhe ishte mbajtur 21 ditë në dhomat e veçimit, pa masë disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se nuk ishin bërë shënimet e nevojshme për këtë ngjarje, ku të sqaroheshin në detaje rrethanat në të cilat, sipas stafit, ishte neutralizuar forcërisht i dënuari në fjalë. Gjithashtu, në kartelat mjekësore nuk rezultonte që personi t'i ishte nënshtruar kontrollit mjekësor. Në I.E.V.P Korçë, një i dënuar pretendonte se ishte dhunuar nga punonjësi i regjimit të brendshëm në IEVP Peqin, prej nga ku ishte transferuar. Rasti i këtij personi iu referua Prokurorisë së Elbasanit, e cila e pushoi çështjen për shkak të transferimit të të dënuarit në një institucion tjetër dhe nuk e transferoi atë në prokurorinë kompetente.

Lidhur me ankesat e të dënuarve për ushtrim dhune, KShH sugjeron që të shqyrtohet me kujdes dhe në mënyrë objektive çdo pretendim. Roli i Prokurorisë dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm (Sh.K.B) është shumë i rëndësishëm për zbardhjen e këtyre rasteve. Gjithashtu, shumë i rëndësishëm është roli i mjekut të institucionit, veçanërisht për sa i takon mbajtjes së evidencave mjekësore. Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT), në rekomandimet e tij për Shqipërinë sugjeron se: *Në kartelën mjekësore të të dënuarit, mbas ekzaminimit mjekësor të të tij/saj duhet të shënohen: 1) deklaratat e bëra nga i dënuari që kanë lidhje me ekzaminimin mjekësor, duke përfshirë edhe përshkrimin e tij/saj për gjendjen shëndetësore dhe çdo pretendim për keqtrajtim. 2) Konstatimet objektive mjekësore në bazë të një ekzaminimi të plotë dhe 3) konkluzionet e mjekut në përputhje me pikën 1 dhe 2. Në rast se ka kërkesë, konkluzionet e mjekut duhet t'i vihen në dispozicion të burgosurit dhe avokatit të tij.*

Kushtet në të cilat mbahen personat e privuar nga liria janë shumë të rëndësishme për të përcaktuar nëse trajtimi ndaj tij/saj është ose jo human. Siç u përmend edhe më lart, në I.E.V.P Rrogozhinë dhe Berat u konstatuan dy raste të personave që flinin në tokë. Në I.E.V.P Lezhë, personat e sapoprانuar në institucion mbaheshin në të njëjtën kat të godinës me pesonat me masë veçimi. Ambjentet ndaheshin ndërmjet tyre vetëm nëpërmjet një rrjete metalike. Në një nga dhomat e observimit ku duhet të qëndronin personat e sapoprانuar, ndodhej bashkë me këta të fundit një person me masë veçimi. Për më tepër, disa nga personat e “rinj” ndodheshin në dhomat e observimit për më shumë se një muaj, pra tej afatit 10 ditor të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Personat e sapoprانuar i nënshtroheshin të njëjtave kufizimeve ndaj aktiviteteve të përbashkëta si dhe personat e veçuar. Në dy nga dhomat e observimit, për shkak të mungesës së tavolinës dhe karrigeve, personat kishin shtruar një batanije në dysheme për të ngrënë vaktet e ushqimit.

III. Personat me probleme të shëndetit mendor



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Një ndër problemet kryesore, që KShH ka ngritur vazhdimisht në raportet mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në institucionet penitenciare dhe në shkresat zyrtare drejtuar institucioneve përgjegjëse shtetërore, është sistemimi i kategorisë së personave me sëmundje mendore në I.E.V.P, të cilat nuk kanë kushtet dhe personelin e përshtatshëm për trajtimin e tyre. Megjithë masat që janë marrë nga Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të bërë funksionalë Spitalin për të Sëmuret Mendorë, të ndërtuar prej disa vitesh në ambientet I.E.V.P Durrës, ky institucion ende nuk ka filluar të funksionojë.

Gjatë vitit 2011, nga vëzhgimet e kryera, janë konstatuar persona të sëmurë mendorë në I.E.V.P Fushë – Krujë, Vlorë, Korçë, Rrogozhinë dhe Burrel. Qëndrimi i këtyre personave në këto institucione, të paspecializuara në këtë drejtim sjell pasoja negative, si në lidhje me trajtimin mjekësor jo adekuat ndaj tyre, ashtu dhe për të dënuarit e tjerë që duhet të bashkëjetojnë me këtë kategori. Në disa institucione të vëzhguara, si në Fushë – Krujë, Lezhë dhe Vlorë, personat e sëmurë mendorë mbaheshin në të njëjtën dhomë me persona të tjerë që nuk kishin diagnoza të tilla. GjEDNj në jurisprudencën e saj¹⁴ konsideron se, veçanërisht, *vlerësimi nëse kushte të veçanta janë ose jo në përputhje me standartet e nenit 3 të Konventës Evropiane (ndalimi i torturës dhe trajtimit ç'njëzësor), në rastet e personave të sëmurë mendorë, duhet bazuar duke marrë në konsideratë vulnerabilitetin dhe paaftësinë e tyre, në disa raste, për t'u ankuar në mënyrë koherente për sa i takon faktit se sa janë prekur ata nga çdo lloj trajtimi i veçantë.*

Në të gjitha institucionet e vëzhguara nga vëzhguesit e KShH nuk kishte mjek psikiatër apo staf mbështetës të kualifikuar për trajtimin e të sëmurëve mendorë. KShH dëshiron të sjellë në vëmendje Rekomandimin nr.(98)7 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me aspektet etike dhe organizative të shërbimit shëndetësor në burgje, ku ndër të tjera parashikohet se *“Në institucionet e mëdha penitenciare duhet të ketë staf psikiatrik. Nëse kjo nuk është e mundur, ashtu si dhe në institucionet e vogla penitenciare, duhet siguruar konsulentë psikiatrike nga një psikiatër që ushtron profesionin në një spital publik ose privat”*. Gjithashtu në këtë rekomandim vijohet më tej se: *“Të dënuarit që vuajnë nga shqetësime të rënda mendore duhen mbajtur dhe trajtuar në ambiente të hospitalizuara, të cilat kanë pajisje të përshtatshme dhe staf të trajnuar për këto diagnoza”*. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimet e saj¹⁵ ka tërhequr vëmendjen lidhur me rëndësinë e rekomandimeve të Këshillit të Evropës, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për shtetet anëtare.

IV. Marrëdhëniet me gjykatën dhe prokurorinë

Vonesat në lëshimin e urdhërave për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim nga organi i prokurorisë, u konstatuan gjatë vëzhgimeve në Paraburgimin e Vlorës dhe Beratit. Situata paraqitej më problematike në Paraburgimin e Vlorës, ku na u referua se vonesat në lëshimin e këtyre urdhërave ishin mbi 5 muaj. Qëndrimi i personave të dënuar me vendim të formës së prerë në institucionet e paraburgimit, përbën jo vetëm shkelje të të drejtave të tyre¹⁶ por krijon, njëkohësisht, premisë për mbipopullimin e institucioneve të paraburgimit.

Në IEVP Rrogozhinë dhe Lezhë, të dënuarit kishin ankesa për refuzim të padrejtë të kërkesave për aplikimin e dënimeve alternative, lirimit me kusht dhe uljen e dënimit. Të dënuarit e I.E.V.P-së Rrogozhinë pretenduan shqyrtim jo objektiv të çështjeve nga Gjykata e Rrethit

¹⁴ *Aerts k. Belgjikës dhe Herzegfahy k. Austrisë*

¹⁵ *Shih Riviere k. Francës, Naumenko k. Ukrainës, Dybeku k. Shqipërisë etj.*

¹⁶ Këta persona edhe pse të dënuar i nënshtrohen rregullave dhe regjimit të paraburgimit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjyqësor Kavajë, mungesë transparence, vonesa në shqyrtimin e çështjeve dhe shkelje të së drejtës së informimit. Një pjesë e të dënuarve në I.E.V.P-në Rrogozhinë kishin ankesa në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar penal në fushën e drejtësisë mes shtetit Italian dhe atij Shqiptar. Këto ankesa kishin të bënin kryesisht me shkelje të parimit *ne bis in idem* dhe mosnjohjen e periudhës së paraburgimit ose dënimit të kryer në Shtetin Italian për efekt të kryerjes së dënimit në Shqipëri.

Në sektorin e të miturve në Paraburgimin e Vlorës, kishte shumë të mitur të paraburgosur të cilët akuzoheshin kryesisht për vjedhje. Kjo kategori personash e grup-moshës 14-18 vjeç vinte kryesisht nga familje të varfëra dhe me probleme sociale. Pjesa më e madhe e tyre nuk ishte recidivistë. Një pjesë e tyre qëndronte për një kohë relativisht të gjatë në këtë institucion. Sipas autoriteteve të këtij institucioni, në disa raste, mbrojtja që i ofrohej kategorisë së të miturve nga avokatët e caktuar kryesisht, familjet e të cilëve nuk kishin mundësi financiare, nuk ishte efektive. KShH vlerëson se aplikimi ndaj këtyre të miturve, i masës së sigurisë arrest në burg, ndikon negativisht në edukimin e tyre, stigmatizimin negativ që shoqëria mund t'u bëjë pasi të jenë liruar nga paraburgimi, ju ofron modelet negative që mund të marrin gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim, duke krijuar baza në të ardhmen për rivendosjen e tyre në pozitat e personave në konflikt me ligjin.

KShH dëshiron të sjellë në vëmendje të aktorëve të sistemit të drejtësisë penale, veçanërisht organeve gjyqësore dhe prokurorisë, rekomandimin e Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës “*Mbi reagimin social ndaj delikuentës së të miturve*” (nr. R(87)20, i miratuar më 17 Shtator të vitit 1987, i cili parashikon se “*I rekomandohet qeverive së shteteve antëre të rishikojnë, nëse është e nevojshme, legjislacionin dhe praktikën e tyre me fokus përjashtimin e të miturve nga mbajtja në paraburgim, përveçse në rastet e krimeve shumë të rënda të kryera nga të mitur në moshë pak më të madhe; në këto raste, të kufizohet periudha e paraburgimit, duke i mbajtur të miturit në ambiente të veçanta nga të rriturit; duke siguruar që vendime të këtij lloji të jepen, në parim, mbas konsultimeve me Departamentin Social që propozon alternativa të tjera të kësaj mase ..*”.

REKOMANDIME

Rekomandime për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë:

- Të përmirësohet infrastruktura në ato I.E.V.P të cilat nuk janë duke u rikonstruktuar, sidomos për përmirësimin infrastrukturor që synon të pengojnë depërtimin e lagështirës, zbutjen e pasojave të amortizimit dhe sigurimin e ndriçimit natyral.
- Të vihet në dispozicion të I.E.V.P-ve si Korça dhe Fushë – Kruja, një fond i veçantë me qëllim sigurimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme të këtyre institucioneve, në mënyrë që ambientet e tyre të mos dalin jashtë funksionimit në të ardhmen.
- Të përmirësohen kushtet infrastrukturore të ambienteve të ajrimit, në ato I.E.V.P që nuk kanë tendë në ambientet e ajrimit, të cilat nuk mundësojnë ajrim të përshtatshëm të personave të privuar nga liria, veçanërisht në kushte atmosferike me mot shumë të nxehtë ose me reshje/borë.
- Të mundësohet furnizimi i vazhdueshëm i I.E.V.P-ve me mjete të përdorimit vetjak si dyshekë, çarçafë, jastëk, batanije, krevatë sipas nevojave dhe kapacitetit maksimal të tyre. Veçanërisht në ato institucione ku ka mbipopullim, KShH rekomandon një koordinim më të mirë mes tyre dhe D.P.B me qëllim evidentimin e nevojave në këtë drejtim dhe adresimin e drejtë të tyre.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Të evitohet në mënyrë kategorike fjetja e personave të privuar nga liria në tokë, sidomos në ato I.E.V.P ku ka mbipopullim.
- KShH sugjeron që në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të shikohet me përparësi gjetja e zgjidhjeve alternative dhe të përshtatshme për plotësimin e stafit mjekësor, me kohë të plotë, veçanërisht në I.E.V.P-të me kapacitet të lartë.
- Kryerja e inspektimeve të vazhdueshme në I.E.V.P-të lidhur me respektimin dhe kryerjen e detyrës nga personeli mjekësor, veçanërisht për ushtrimin e kontrollit mjekësor periodik të personave të privuar nga liria dhe evidentimin e gjendjes së tyre shëndetësore në kartelat mjekësore përkatëse;
- Të bashkëpunohet me specialistë të Ministrisë së Shëndetësisë për të kryer inspektime të përbashkëta me qëllim evidentimin e gjendjes shëndetësore të personave me sëmundje të rënda, që mbahen në I.E.V.P, përshtatshmërinë e kushteve në të cilat këta persona mbahen dhe shërbimit mjekësor që atyre u ofrohet. Të mundësohet transferimi i këtyre personave në ato I.E.V.P që kanë stafin e nevojshëm mjekësor dhe kushte të përshtatshme për trajtimin e tyre.
- Të sigurohet furnizimi i I.E.V.P-ve me medikamentet e nevojshme, veçanërisht i institucionit të Burrelit dhe Beratit, në përputhje me nevojat që përshkruan stafi mjekësor, bazuar në diagnozat e të sëmurëve që ka institucioni;
- Të merren masa të menjëhershme për të vënë në funksionim menjëherë institucionin e burgut për të sëmurët mendorë.
- Të mundësohet transferimi në Institucionin e Zaharisë, Krujë dhe në Spitalin e Paraburgimit të Durrësit, i të sëmurëve mendorë që qëndrojnë në I.E.V.P të ndryshme pa kushte të përshtatshme dhe pa staf mjekësor të specializuar.
- Të përmirësohet infrastruktura dhe të krijohen kushtet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve me karakter social – edukativ të personave të privuar nga liria në I.E.V.P-të Tepelenë, Burrel, Lezhë dhe Korçë. Trajtimi i përshtatshëm social – edukativ siguron rehabilitimin dhe integrimin e të dënuarve duke minimizuar pasojat e qëndrimit në një ambient të mbyllur.
- Të bashkëpunohet me Ministrinë e Arsimit për të mundësuar dhënien e disa orëve mësim për të miturit në Paraburgimin e Vlorës, në mënyrë që këta të mitur të mos krijojnë shkëputje të gjata nga shkolla gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim.
- Të ushtrojnë kontrole më të detajuara në I.E.V.P Fushë – Krujë për sa i takon respektimit të kërkesave të parashikuara në ligj lidhur me mirëfunksionimin e mekanizmit kërkesë – ankesë në këtë institucion.
- Të sigurohet që çmimet e artikujve që shiten në dyqanet e të gjitha I.E.V.P-ve të mos kalojnë tavanin e çmimeve të zonës përreth.
- Të punohet në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të stafit me uniformë në I.E.V.P për çështje të tilla si: respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria, respektimi i etikës së sjelljes dhe komunikimit etj.
- Në rastet e pretendimeve për dhunë, personat e privuar nga liria t'i nënshtrohen sa më shpejt të jetë e mundur kontrollit mjekësor dhe të sigurohet pasqyrimi në mënyrë objektive i pretendimeve të tyre dhe konkluzioneve të mjekut për sa konstatohet dhe pretendohet. Në rast pamundësie, të sigurohet ekzaminimi mjekësor sa më i shpejtë i personit në një spital civil.
- Personat e sapopranuar në I.E.V.P Lezhë të vendosen në ambiente të përshtatshme dhe të mos mbahen në ambiente të mbyllura tej afatit 10 ditor.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Rekomandime drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme:

- I rekomandohet organit të Prokurorisë të shqyrtojë me përparësi dhe objektivitet çdo pretendim për dhunë nga personat e privuar nga liria nga këndvështrimi i nenit 86 dhe 87 i Kodit Penal;
- I rekomandohet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda kompetencave të tyre, të nxitin në rrugë institucionale rritjen e numrit të masave dhe dënimeve alternative, veçanërisht për personat vulerabël, që kanë probleme të rënda të shëndetit dhe/ose që kanë probleme sociale – ekonomike, sidomos për të miturit;
- I rekomandohet organit të Prokurorisë të mos zvarrisë ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë me burgim dhe të operojë me shpejtësi dhe efikasitet në këtë drejtim, në përputhje me ligjin;
- I rekomandohet Prokurorisë së përgjithshme të kontrollojë veprimtarinë e organeve në varësi, në lidhje me vënien në ekzekutim të vendimeve penale, vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore për mjekim të detyruar dhe për ndjekjen penale të rasteve të dhunimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar.
- I rekomandohet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të kenë në fokus të veçantë të punës së tyre adresimin dhe zgjidhjen e çështjes së të miturve të paraburgosur, për sa i takon reduktimit të numrit të aplikimeve të masës së sigurisë “arrest në burg”, gjykimit me shpejtësi të çështjeve të tyre dhe rritjes së aplikimit të dënimeve alternative.